


MINISTRISË SE MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
KOMUNËS SE PRISHTINËS

LENDË: KERKESË

		REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - Vlada KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO SREDINË I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING	
Nr. i Orig. Org. Udh. Org. Udh.	M; SP	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	436/20
Nr. i Fazës Srejtavanja Broj Fazës	02	Data. Datum Date	23.01.20
Prishtinë / a			

Grupi i qytetarëve për mbrojtjen e Liqenit të Badovcit kërkon nga MMPH dhe Komuna e Prishtinës që të marr për bazë shqetësimet e qytetarëve dhe të veprojnë sipas legjislacionit konform kërkesave të poshtëshënuara:

I. Te anulohet Vendimi i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me Nr. Prot. A-76/2019 i datës 27.06.2019 me të cilin shfuqizohet vendimi i Komunës me të cilin palës i refuzohet kërkesa për dhënie të kushteve ndërtimore për Lagjen në Badovc.

II. Te anulohet Vendimi i Komunës së Prishtinës i datës 26.12.2019 për caktimin e kushteve ndërtimore për ndërtimin e Lagjes në Badovc.

III. Te harmonizohen aktet nënligjore, që rregullojnë mbrojtjen e zonave ujore: Vendimi i Qeverisë së Kosovës 16/127 për Badovcin, Udhëzimin Administrativ MMPH – Nr.08/2017 Për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor dhe Udhëzim Administrativ MMPH – Nr.15/2017 Për Zonat e Mbrojtura Sanitare, me Ligjin Nr. 04/l-147 Për Ujërat e Kosovës.

IV. Te fillohen procedurat që zonën përreth Liqenit të Badovcit ta shpallim peisazh të mbrojtur duke e bashkuar me Peisazhin e Mbrojtur të Germisë dhe në vendim të shënohet që ndalohen të gjitha llojet e ndërtimeve në këtë zonë.

V. Te ndalohet planifikimi i lagjeve dhe objekteve turistike në zonat përreth liqeneve akumuluese dhe të merren masa të menjëhershme, për largimin e objekteve ilegale dhe legale që janë ndërtuar brenda zonës së dytë mbrojtëse (210 metra) të liqeneve akumuluese.

Nga institucionet e lartshënuara kërkohet që në afat optimal (prej 8 ditësh) të vendosin sipas kërkesave të qytetarëve, duke anuluar vendimet e kundërligjshme, marrjen e masave për mbrojtjen e të gjitha liqeneve akumuluese dhe filluar procedurën për harmonizimin e legjislacionit.

Prishtinë

Me 22.01.2020

Grupi Koordinues i Qytetarëve për Mbrojtjen e Badovcit

ARDIAN NRECAJ 1030922587 *clj*

EGZONA SHALA 1174893574 *clj*

ALI SEFAJ 1002217330 *Admiral*

ZATON BEGOLLI 1000366532 *Zat*



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

DATË/A:	28.01.2020
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Grupin Koordinues të Qytetarëve për Mbrojtjen e Badovcit
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	DKP - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigjeje në Kërkesën Nr.439/20

Të nderuar,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) është duke i përcjell me vëmendje zhvillimet e fundit rreth shqetësimeve të qytetarëve në mbrojtje të Liqenit të Badovcit, me ç'rast edhe ka shprehur gatishmërinë të përgjigjet në çdo kërkesë të parashtruar pran MMPH-së, andaj, me kujdes të veçantë ka shqyrtuar edhe kërkesën tuaj dhe ju siguron që të gjitha pikat e potencuara në kërkesë do ti trajtojmë me prioritet, profesionalizëm dhe transparencë.

Për informimin tuaj, bazuar në kompetencat të cilat i parasheh Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Vendimi i MMPH me Nr. A-76/19 i dt. 27.06.2019 është marr në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal; Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 16/127 dt. 24.02.2013 për Përcaktimin e Zonave Mbrojtëse të burimit Ujor përreth Liqenit të Badovcit; Ligjin Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe Udhëzimit Administrativ MMPH 06/2017 për Përcaktimin e Procedurave për Përgatitjen dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushtet Ndërtimore dhe Lejen Ndërtimore dhe Leje rrënimi për Kategorinë e I dhe të II të ndërtimeve. Andaj, MMPH do të shfuqizojë Vendimin vetëm nëse Gjykata konstaton se ka shkelje ligjore dhe vendos që Vendimi të shfuqizohet.

Gjithashtu, MMPH do të analizoj të gjitha aktet nënligjore dhe në rast se ato kanë mos harmonizim në mes vete dhe nuk janë në përputhje me Ligjet në fuqi do ti inicioj propozimet për ndryshimin e tyre konform procedurave të parapara ligjore.

Në vazhdimësi të kërkesës tuaj, lidhur me propozimet e juaja të përcaktuara në pikën IV dhe V, ju informojmë se në Janar të vitit 2019 është miratuar nga Qeveria, Koncept Dokumenti për Ujërat e Kosovës, mirëpo në këtë dokument i cili është dokument politik dhe i cili i paraprin ndryshimeve apo krijimit të politikave të reja, nuk janë rekomanduar trajtimi i këtyre çështjeve nga organet të cilat janë kompetente siç janë:

Këshilli Ndërmintor i Ujërave, i cili bazuar në nenin 17 të Ligjit Nr.04/L-147 për ujërat është kompetent për dhënien e rekomandimeve për zhvillimin e politikave nga fusha e ujërave;

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), e cila bazuar në nenin 60 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit është kompetente për hartimin e koncepteve dhe propozimeve profesionale lidhur me kornizën e të dhënave për mjedisin dhe cila i propozon MMPH-së dhe ministrive tjera ndërmarrjen e masave për përmirësimin e gjendjes së mjedisit;

Departamenti Ligjor - Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit, i cili bazuar në nenin 35 të Rregullores (QRK) Nr.05/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës së MMPH-së është kompetent për identifikimin e problemeve në zbatimin e akteve nënligjore dhe koordinimin me të gjitha strukturave të MMPH-së për zbatimin e legjislacionit.

Mirëpo, pavarësisht kësaj me qëllim të mbrojtjes së resurseve ujore të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimit sociale - ekonomik të Republikës së Kosovës ju sigurojmë se MMPH do të filloj iniciativat për trajtimin e kësaj çështje me prioritet duke kërkuar fillimisht që të përgatiten rekomandimet dhe ekspertizat profesionale nga Këshilli Ndërmintor i Ujërave, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Departamentet përkatëse të MMPH-së si dhe institucioneve tjera relevante.

Gjithashtu, ju inkurajojmë juve si Grup Koordinues të Qytetarëve për Mbrojtjen e Badovcit që kërkesën tuaj ta bëni më të qartë duke specifikuar saktë se cilat dispozita ligjore ju i konsideroni se janë aplikuar kundërligjshëm në zbatim të Ligjit gjatë marrjes së Vendimit të MMPH-së; po ashtu të specifikon se cilat dispozita të akteve ligjore janë në kundërshtim dhe ku ka mos harmonizim të legjislacionit në fuqi si dhe arsyetimin ligjor të formës së adresimit të politikave të reja konform procedurave të parapara ligjore.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt!